



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 120 Prot.

Tiranë, më datë 14.02.2025

**VENDIM**

**Nr. 108, datë 14.02.2025**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.02.2025:

**VENDOSI**

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes për projektin “Rikonstruksion i banesës me kod arkivi K-040”, Brenda Qendrës Historike të qytetit të Beratit, me aplikues Z. Jorgo Xuhano dhe zhvillues **Z. Kostandin Plaku me argumentin;**
    - Të hartohet një relacion i detajuar nga DRTK Berat për ndërhyrjet historike në objekt para dhe pas zjarrit, si dhe të plotësohet dhe detajohet projekti me të dhëna teknike (kuota, dimensione etj);
  2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
  3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**

**Joli MITROJORGJI**

